KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr 1773 prot *Vlorë më 06/07/2026*

VENDIM

Nr 10 datë 29.06.2026

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PARAPRAK 2027-2029 PËR KËSHILLIN E QARKUT VLORË

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 77; Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 29.03.2012, "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", i përditësuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 06, datë 27.02.2026, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Vendor Afatmesëm 2027–2029".

VENDOSI :

1. Të miratojë dokumentin paraprak të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, për Këshillin e Qarkut Vlorë, të përgatitur sipas Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV).
2. Të miratojë relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së dokumentit paraprak të PBA 2027-2029.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Sektori Financë dhe Shërbime.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Grupi i punës:

Anisa Hyseni
Drejtor i Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social

Mauricio Pashaj
Specialist Finance për Zbatimin e Buxhetit

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600